

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE (e vendosur ne objektin e Deges se kesaj Gjykate ne Vushtrri), gjyqtari Skender Shala, ne çeshtjen juridike te paditeses nga , te cilin e perfaqeson avokati nga , sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditures nga , tani me vendbanim te panjohur, te cilen e perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem avokati nga , sipas aktvendimit te kesaj gjykate, baza e kontestit, per vertetim pronesie, vlera e kontestit 1.200,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt.10.02.2015, bie kete:

AKT GJYKIM

I – APROVOHET kerkespadia e paditeses dhe **VERTETOHET** se paditesja nga eshte pronare e parceles katastrale nr. , me kultur shtepi , ne vendin e quajtur „Rr. ”, ne sipërfaqe prej **S=84m2** dhe oborr ne sipërfaqe prej **S=175m2**, me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne sipërfaqe te pergjithshme prej **S=259m2**, e cila evidentohet ne emer te te paditures () I/1, sipas çertifikates se pronesise me nr. te lendes ZK.

II – OBLIGOHET e paditura qe t'ia njoh kete te drejte paditeses dhe t'i lejoje qe paditesja kete paluajtshmeri ta regjistroje ne emer te saj, ne librat e tokes te Zyra Kadastrale Komunale ne , ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesja ne padin e saj te parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te saj ne seancat e mbajtura ka theksuar se qysh ne vitin 1974, ne baze te kontrates me shkrim, e ka blere nga bashkshorti I te paditures paluajtshmerin e cekur si ne dispozitiv per shumen kontraktuese prej 210.000.000 din te athershem dhe qe nga momenti i shitblerjes I njeiti se bashku me familjen e tij ka hyre ne posedim te prones, ku ne vazhdimesi e ka shfrytezuar pa asnje lloj kufizimi apo pengese. Paditeja tani vone e ka kuptuar qe paluajtshmeria e cila eshte ne posedim faktik te saj qe nga blerja e saj nuk evidentohet ne emrin e saj, andaj, ka interes juridik qe kjo paluajtshmeri edhe juridikisht te evidentohet ne emrin e tij.

Pasi qe i padituri eshte ne adrese te panjohur i propozoje gjykates qe te ua caktoi perfaqesuesin e perkohshem.

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesor beri precizimin e kerkesapdise sa I perket siperfaqes, shtrirjes dhe perkufizimit te paluajtshmerise dhe ate sipas konstatimit dhe mendimit te ekspertiit gjeodet si ne ekspertize. Ne fjalen e tij perfundimtare theksoi se nga provat e nxjerrura ne shqyrtimin e sotem ne menyre te pakontestueshme u vertetua bazushmerija e kerkespadise. Andaj, Gjykates I propozoj qe te njejten ta aprovoj si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e konform nenit 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK-es, gjykata me aktvendimin C.nr.771/2013, te dt.09.01.2015, te paditures ia caktoi Perfaqesuesin e perkohshem, av. _____, i cili ne baze te ketij aktvendimi do t'i ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nenit 82.1.2 te LPK-es.

Perfaqesuesi i perkohshem i te paditurve ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesit ne shqyrtimin kryesor dhe ne fjalen perfundimtare deklarojse Gjykates I propozoj qe conform rrezultatit te provave ne proceduren provuese te bie vendim meritor lidhur me kete ceshtje juridike-civile.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi nga keto arsye.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: kontraten mbi shitblerjen e paluajtshmerise e dt. 01.05.1974, cartifikaen mbi pronenin me nr. _____, ZK _____, ZKK _____, te dt.27.01.2015, ne emer te te paditures, procesverbalin mbi vendshiqqim C.nr.771/13. Te dt. 23.01.2015, ekspertizen e ekspertit gjeodet _____ te dt.27.01.2015, beri veshrtim ne skicen e terenit dhe kopia e planit nga I njejt ekspert gjeodet _____, ndegjoi deshmitaret _____ ni dhe _____ qe te dy nga _____ dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga kontraten mbi shitblerjen e paluajtshmerise e dt. 01.05.1974, konstatohet se paditsja e ka blere nga bashkshorti I te paditures _____, paluajtshmerin e cekur si ne dispozitiv per shumen kontraktuese prej 210.000.000 din te athershem.

Nga cartifika mbi pronenin me nr. _____, ZK _____, ZKK _____ te dt.27.01.2015, e cekur me lart, konstatohet se pjesa e parceles katastrale nr. _____ evidentohet ne emer te te paditures _____ (_____/1).

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera te pjesees kontestuese te paluajtshmerise nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Kadastrit ne , ka vertetuar se paluajtshmerija kontestuese bjen - gjegjesisht e perbene pjeset e parceles te cekur me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe ne skicen e terenit, e cila eshte pjese perberse te kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga procesverbali mbi vendeshiqimin i kesaj gjykate te cekur me larte konstatohet se gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejte ne vend konstatoi se paluajtshmerija kontestuese eshte e kufizuar ne anen veriore, perendimore dhe lindore me prone private, ndersa ne anen veriore me rruge kryesore. Ne kete paluajtshmeri gjinden objekte te ndertuara dhe ate shtepija njekatshe e ndertuar ne vitin 1973 (sipas ekspertit gjeodet), e rindertuar ne themelet e shtepise se vjeter. Ne v.2001. Palujtshmerija eshte e rrethuar me mur prej tullave te vjetra. Ne hyrje te oborrit jane te vendosura dyerte metalta qe isherbejne paditeses per hyrje ne oborrin e shtepise se tij, (sipas ekspertit gjeodet).

Deshmitari I deklaroj se ai personalisht e din se paditesja e ka blere ne vitin 1974 nga shitesi me emrin , ne siperfaqe prej diku afersiht 2-3 ari, me qmim te shitblerjes I cili nuk me kujtohet vetem e di se e njejta i ka paguar te gjitha te hollat shitesit. E di se me rastin e shitblerjes palet kan nenshkruar nje kontrat me shkrim , e di se te njejtit se bashku me anetaret e familjes kane hy ne posedim dhe shfrytezim te asaj paluajtshmerie . E di dhe jam I sigurit se nga momenti I shitblerjes deri me sot te njejtit nuk kane pas kurrfar pengesash dhe as kundershetimesh nga askush perkritazi me shfrytezimin dhe posedimin e asaj paluajtshmerie. Momentin e shitblerjes ajo paluajtshmeri ka qene e rrethuar me mur te vjeter prej tullash (qerpiqeve). Me rastin e shitblerjes ne ate paluajtshmeri ka ekzistuar nje shtepi ne te cilen kane jetuar deri ne vitin 1999 kur ka shperthyer lufta ne Kosove ku e njejta eshte djegur, ndersa pas lufte ne te njejtat themele kane ndertuar shtepine me te njejtat dimensione. Keto rrethana me jane te njohura sepse une jetoj ne fqinjesi me palen paditese dhe te njejtit I njof qysh prej kur jane vendosur per te banuar ne ate lagje.

Deshmitari deklaroj se ai personalisht e din se paditesja e ka blere paluajtshmerine nga shitesi me emrin ne vitin 1974 , ne siperfaqe prej rreth 2 ari, me qmim te shitblerjes si ne kontrat prej 210 milion dinare te atehershem . E di se shitblerja eshte bere ne baze twe marreveshjes me shkrim ne mes te tani paditures dhe shitesit me emrin Ilija I cili ka qene bashkeshorti I tani ketu te paditeses . E di dhe jam I sigurit se paditsja ia ka paguar ne teresi cmimin e shitblerjes sepse une personalisht kam qene present ne momentin e asaj kontrate dhe se e kam vu nenshkrimin si I pranishem ne ate shitblerje. E di se prej momentit e shitblerjes paditesja me anetaret e familjes menjeher ka hy ne posedim dhe shfrytezim te asaj paluajtshmerie sepse aty ka ekzistuar nje shtepi te cilit jan vendosur menjeher per te banuar. E di se paluajtshmeria prej ateher ka qene e rrethuar me mur dhe ka pas disa objekte percjellese si shupa e tj. Te cilat jane edhe sot e kesaj dite. E di se prej momentit kur jane vendos ne ate shtepi dhe ne ate truall e deri me sot nuk kane pasur kurrfar pengesash ne shfrytezimin dhe posedimin e saj. Keto rrethana me jane te njohura nga fakti sic I cekta me larte sepse paditesen e kam grua te vellaut dhe kam shku shpesh tek ata, dhe se ateher kam jetuar me vite ne ate lagje.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me lart, gjykata erdhi ne perfudim dhe konstatoi se paditsja patundshmerin tani lendore e ka blere qysh ne vitin 1974, ne baze te kontrates me shkrim nga bashkshorti I te paditures dhe se qmimin e shiteblerjes, shitesit ia ka paguar ne tersi, te cilen shitesi menjeher i'a ka lene ne disponim dhe shfrytezim te lire kete paluajtshmeri paditeses e cila se bashku me anetaret e familjes se saj e ka shfrytezuar pa pengesa qe nga momenti i shitberjes e tani e tutje e shfrytezon.

Ne baze te nenit 28 p.4 te LMTHJP eshte percaktuar se: Mbajtjesi me mirebesim I sendit te paluejtshem , mbi te cilin tjetri ka te drejten e pronsise, fiton te drejten e pronsise mbi kete send me parashkrimin fitues me kalimin e kohes prej 20 (njetzet) vjetesh.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes, paditesja e ka pasur ne shfrytezim dhe disponim te lire kete paluajtshmeri dhe ate: me mirebesim dhe pa pengesa nga askush, andaj ne anen e paditeses ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronesise ne baze te mbajtjes e keto jane: mbajtja me mirebesim, koha e nevojshme si dhe shfrytezimi i papengueshem i ketyre paluajtshmerive.

Mbajtja me mirebesim ekziston nga se paditsja kete paluajtshmeri e ka blere nga nga bashkshorti I te paditures

Koha e nevojshme mbi 20 (njetzet) vite, ekziston sepse paditesja e ka blere kete paluajtshmeri nga bashkshorti I te paditures , qysh nga viti 1974.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes paditesja ka hyre ne posedim dhe shfrytezim te lire dhe te papengueshem te kesaj paluajtshmerive te tij, gjere me tani.


Andaj, gjykata konkludon, se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditeses me mbajtje, konform nenit 28 p 4 te LMTHJP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore, bazaohet ne baze te nenit 450 dhe 459 te LPK-es.

Nga te cekurat me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.771/2013, dt.10.02.2015.

Gjyqtari,
Skender Shala



KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa, ne afat prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA

Saktesin e pershkrimit e verteton:

PRISTINE I PLOTI DOKUMENTI
DOKUMENTI PRAVNOG NAZNA
THEMELORE / OSNOVNI DOKUMENTI
MITROVICE - MITROVICA

18. 03. 2015

